

L I G J
Nr.9580, datë 13.7.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8408, DATË 25.9.1998 “PËR POLICINË E NDËRTIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, të ndryshuar, pika 2 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“2. Të vendosë gjoba për shkeljen e dispozitave ligjore të mësipërme. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Përgjatimisht, për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime dhe shpenzime operative, është ajo që Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ka miratuar për Policinë e Ndërtimit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4996, datë 25.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu